LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>6</i> | |
|---|--------------------------------|--------------|------------------------|--|-------|
| Shërbimi | Përshkrimi i shërbimi | Sasia | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim(3 x 4X) | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | Çmimi total (Shërbimet) | | | | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH | | | | | |
| TVSH (%) | | | | | |
| Çmimi total me TVSH: | | | | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | | | | |
| Nënshkrimi | | | | | |
| Vula | | | | | |
| Datë _____ | | | | | |

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Hartim i Projektit të rikonstruksionit, të filialeve të Posta Shqiptare sh.a,si më poshtë:

| NR | FILIALI | OBJEKTI (EMRI I ZYRËS POSTARE) |
|----|-------------|---|
| 1 | Shkoder | Zyra Postare Qender Shkoder |
| 2 | Korce | Zyra Postare Qender Korçe |
| 3 | | Zyra Postare Qender Pogradec |
| 4 | Gjirokaster | Zyra e Administrates Gjirokaster |
| 5 | Lezhe | Zyra Postare Kurbin-Laç Qender |
| 6 | | Zyra Postare Mirdite(Rëshen) |
| 7 | Berat | Ura Vajgurore |
| 8 | | Zyra Postare Nr 1 Kuçovë |
| 9 | | Administrata +Zyra Postare Skrapar |
| 10 | | Zyra Postare Poliçan |
| 11 | Elbasan | Zyra Postare Prrenjas |
| 12 | Kukes | Zyra Postare Bajram Curri Nr1(pensione) |
| 13 | Fier | Zyra Postare Roskovec |
| 14 | | Zyra Postare Fier 1 |
| 15 | | Zyra Postare Fier 2 |
| 16 | Vlore | Zyra Postare Vlora 2 |
| 17 | Durres | Zyra Postare Durres Nr.5 |
| 18 | Sarande | Zyra Postare Aliko |

DETYRË PROJEKTIMI

- **PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM**

“Posta Shqiptare” Sh.a zhvillon aktivitetin e shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke synuar rritjen e cilësisë të të gjitha llojeve të shërbimit për klientët dhe gjithashtu përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e saj.

- **OBJEKTIVI**

Është hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të objekteve të Postës Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambjentëve përreth dhe infrastrukturës.

Projektet e rikonstruksioneve të këtyre Objekteve, duhet të realizojnë dhe mundësojnë studimin dhe analizimin e problemeve ekzistuese si dhe dhënien e zgjidhjeve më optimale për realizimin e qëllimit përfundimtar.

- **STANDARDET NË PROJEKTIM**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjisllacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave.

FILIALI SHKODËR :

1-ZYRA POSTARE QENDËR-SHKODËR

A- VENDODHJA E OBJEKTIT :

Zyrat Qëndrore me sip. Ndërtese 533 m², Lagjia “ Vasil Shanto”, Shkodër.

Prona ndodhet në pjesën qendrore të qytetit të Shkodrës përballë Hotel Rozafa (ishTurizmi) ne rrugen Teuta.

Prona është e pozicionuar ne rrethrotullimin e Perashit, rrethrotullim i cili lidhe pese rruge te cilat do te detajohen e me poshte.Ky pozicionim i jep prones i jem shume mundesi komunikimi.

Ne Veri prona kufizohet me nje shesh dhe ne distance rreth 150 m ndodhet nje rreth rrotullim e me tej ne distance rreth 300 m kalon rruga Clirimi.

Ne Jug te prones ndodhet nje ndertese dhe ne distance rreth 40 m ne vije ajrore kalon rruga “ 16 Nentori”.

Ne Lindje kufizohet me trotuar dhe me rrugen “Salih Ago”. Ne jug-lindje ne distance rreth 160 m ndodhen godinat e UKSH dhe te Albtelekomit.

Ne Perëndim prona lidhet me vazhdimin e rruges “ Clirimi”.

Infrastruktura dhe rruga kryesore në gjëndje të mirë mirëmbajtjeje, por rruga dytesore ka nevojë per permiresime.Zonë qendrore me përdorim kryesisht rezidencial dhe komercial, pallate 5 dhe 6 kateshe, ndërtesa publike dhe shtepi 1 dhe 2 kateshe.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a)Pershkrimi i jashtëm :


Posta e kryen shërbimin për publikun në një pallat me 6kate me themele të vazhduara , murature tulle të plote dhe të suvatuara. Në pjesën e sipërme ndërtesa është e mbuluar me solete betoni. Gjithashtu pjesë e çatise janë edhe sistemi i ulluqeve. Ndërtesa është disi e amortizuar pasi nuk është mirëmbajtur në mënyrë të rregullt. Muret e jashtme janë pjesërisht të suvatuara. Është e plotesuar me dritare dhe dyer me kasa duralumini. Aksesit për në pronë realizohet me ane të disa shkalleve me mermer, të vendosura përpara ndërtesës. Ndërtesa i

eshte nenshtruar rikonstruksionit pjesor vitet e fundit kryeshisht ne tarracen e objektit ku eshte bere hidroizolimi i saj.


b) Pershkrimi i brendshëm :

Posta e kryen sherbimin per publikun ne nje pallat me 6kate me themele te vazhduara,murature tulle te plote dhe te suvatuar. Ne pjesen e sipërme ndertesa eshte e mbuluar me solete betoni. Gjithashtu pjese e çatise jane edhe sistemi i ulluqeve. Ndertesa eshtë shërbimeve, përpunimit dhe magazinës.Përsa i përket zyrave dhe ambjenteve të tjera të shërbimeve të katit përdhe ata janë të shtruara me pllaka por jane te demtuara nje pjese e mire e tyre dhe amortizuara.Muret e ambjenteve ne sallën kryesore dhe pas sallës kryesore ka prezencë të, suvatimet e mureve dhe tavaneve kanë rënë në një pjesë të konsiderueshme të tyre.Dyert e zyrave të këtij kati jane shumë të vjetëruara dhe të amortizuara ,shkallët lidhëse prej mermeri të katit përdhe me katin e parë te vjetëruara dhe konsumuara.Ndricimi në sallë dhe të gjitha ambjentet e këtij kati i dobët i amortizuar .

Kati I-re është në funksion të zyrave të administratës të filialit, pllakat e koridorit të katit të parë janë të disi te amortizuara , ka renie suveje ne disa zyra për shkak se ka rrjedhje uji nga tarraca.Zyra e Drejtorit te Filialit është rikonstruktuar kohet e fundit.Hidroizolimi i tarracës sipër zyrave të administratës dhe sipër ambjenteve të sallallave së katit përdhe ka nevojë per nderhyrje te lehta pasi paraqitet ne gjendje pergjithesisht te mire.Rrjeti elektrik dhe internetit është plotesisht i amortizuar.



ZYRA POSTARE SHKODER KATI PERDHE
EGZISTUESE SH 1:100




H E KATIT 320 CM
H E SALLES 470 CM
DERE 80/200 CM
DERE 90/220 CM
DERE 200/220 CM
DRITARE 150/180 CM
DRITARE 170/180 CM

POSTA SHQIPTARE sh.a

EMERTIMI

PUNOI

ZYRA POSTARE SHKODER KATI I-re
EGZISTUESE SH 1:100




H E KATIT 320 CM
DERE 80/200 CM
DERE 90/210 CM
DERE 200/220 CM
DRITARE 130/180 CM
DRITARE 170/180 CM

POSTA SHQIPTARE sh.a

EMERTIMI

PUNOI







FILIALI KORÇË :

1-ZYRA POSTARE QENDËR-KORÇË-KATI PËRDHE SALLA E SHËRBIMIT

A- VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyrat Postare Qendër Korçë ka një sip. 305 m² kati në Rr."Edit Durham", Zyrat e Postës Qendër në qytetin e Korçës ndodhet në rrugën "Edith Durham" , në jug të Teatrit "A,Z,Çajupi".

Në veri prona kufizohet godinën e Teatrit të qytetit dhe në distancë rreth 180 m, kalon rruga "Midhi Konstani". Më në veri ndodhet një lulishte dhe në distancë rreth 600 m gjendet territori i ish kombinatit Tekstil.

Në jug prona kufizohet me rrugën "Edith Durham" dhe më tej në distancë rreth 200 m, ndodhet Gjimanzi "Themistokli Gërmenji". Më në jug, në distancë rreth 320 m në vijë ajrore, ndodhet Godina e Bashkisë. Në jug-lindje në distancë rreth 70 m gjenden Hotel "Grandi" dhe "Kocibelli" dhe në distancë rreth 150 m ndodhet Biblioteka "Thimi Mitko".

Në lindje prona kufizohet me Sheshin e Teatrit dhe në distancë rreth 60 m, kalon Bulevardi "Shën Gjergji".

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Njësia është pjesë e një pallati të ndërtuar rreth viteve 1980 dhe ndodhet në katin përdhe, një pjesë të katit nëntokë dhe një pjesë të katit të parë të saj. Ndërtesa ka konstrukcion me themele të vazhduara, me mure perimetral tulle, solete me traveta dhe të hidroizoluar. Fasada e njësisë është e suvatuar dhe e veshur me pllaka guri dekorative. Posta e kryen shërbimin për publikun në një pallat me 6kate me themele të vazhduara , murature tulle të plote dhe të suvatuar. Në pjesën e sipërme ndërtesa është e mbuluar me solete betoni. Gjithashtu pjesë e çatise janë edhe sistemi i ulluqeve. Ndërtesa është disi e amortizuar pasi nuk është mirëmbajtur në mënyrë të rregullt. Muret e jashtme janë pjesërisht të suvatuara. Është e plotësuar me dritare dhe dyer me kasa duralumini. Aksesit për në pronë realizohet me anë të disa shkalleve me

mermer, te vendosura perpara ndertesës. Ndertesa i është nënshtruar rikonstruksionit pjesor vitet e fundit kryesisht në terracën e objektit ku është bërë hidroizolimi i saj.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Salla e shërbimit është në gjendje jo shumë të mirë, pjesërisht e mirëmbajtur dhe e rinovuar pjesërisht që nga dita që është ndërtuar. Ambjenti i katit përdhe është i përbërë nga 1 ambjent sporteli, 6 zyra dhe një tualet dhe koridor. Dyshemeja në të gjithë ambjentet është e shtruar me pllaka gres dhe e pajisur me plintues. Muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të lyer.

Ambjenti i hollit i ndarë në disa ambjente, ku ambjenti i pritjes së klientëve zë hapësirën më të madhe, kurse dy ambjentet e shërbimit ndodhen një në katin përdhe dhe një në ndërkat.

Ambjenti i shërbimit në katin e parë, është i ndarë me banak në formë L-je, kurse ai i ndërkatit me një banak të gjatë të drejtë dhe në hapësirën e lartësisë mbi ½ të tyre, vendosur xhama në profile duralumini, kurse në pjesën e sipërme ka tavan të varur me ndriçim.

Shkallët e brendshme të pronës, ato të hollit, ndërkatit, katit të parë dhe ato zbritëse për katin nëntokë, me bazamakë mermeri, shkallët zbritëse të katit nëntokë, të siguruara me parmak hekuri të thjeshtë nga një krah.

Kati përdhe është në funksion të punjonjësve, sallave të shërbimeve, përpunimit dhe magazinës. Muret e ambjenteve në sallën kryesore dhe pas sallës kryesore ka prezencë të lagështirës, suvatimet e mureve dhe tavaneve kanë rënë në një pjesë të konsiderueshme të tyre. Dyert e zyrave të këtij kati janë shumë të vjetëruara dhe të amortizuara, shkallët lidhëse prej mermeri të katit përdhe me katin e parë të vjetëruara dhe konsumuara. Ndricimi në sallë dhe të gjitha ambjentet e këtij kati i dobët i amortizuar. Vettrat e dritareve, përjashtuar ato të fasadës e cila është me vettratë xhami të fiksuar në konstruksion me profile duralumini, janë me profile duralumini dhe pjesërisht të mbrojtura me zgara hekuri. Nga pjesa e brendshme e dritareve, vendosur grila të varura me material metal-plastikë. Dyert e brendshme janë pjesërisht druri tamburato dhe pjesa tjetër janë me profile duralumini me xham. Tualetet janë të shtruar me pllaka gres dhe muret të veshura me pllaka majolike. Tualetet janë të pajisura me wc e lavaman por të amortizuara. Instalimet elektrike janë brenda murit me celësa e priza. Rrjeti elektrik dhe internetit është plotësisht i amortizuar.

2-ZYRA POSTARE QENDËR-POGRADEC

ZYRAT FILIALI KORÇË. DEGA POGRADEC-ZYRA POSTARE QENDËR

Zyrat Postare me sip. totale 647.7 m², ndodhur në lagjen “Nr.2”, Rruga “Rinia”(Posta Qendrore), Pogradec

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Pogradecit, rreth 140 km në jug-lindje të Tiranës, 35 km në veri të qytetit të Korçës . Prona ndodhet në qendër të qytetit, 270 m në lindje të godinës së Bashkisë dhe 20 m në anën jugore të rrugës “Reshit Çollaku”.

Në veri prona kufizohet me rrugën “Reshit Çollaku” dhe në distancë rreth 150 m ndodhet godina e Ish hotel Turizmit dhe po në këtë drejtim në distancë rreth 180 m, ndodhet bregu i Liqenit.

Në jug prona kufizohet me ndërtesa 4-5-katëshe dhe në distancë rreth 300 m kalon rruga “Gani Butka”.

Në lindje prona kufizohet me rrugën “Rinia” me akses të drejtpërdrejtë me të. Më në lindje gjendet një pallat i ri 13 katësh në katin e parë të cilit gjendet dega e bankës “Alfa” dhe më në lindje, në distancë rreth 370m në vijë ajrore, kalon bulevardi “Dëshmorët e Pojskës”.

Në perëndim prona kufizohet me disa ndërtesa 2-3-katëshe dhe më në perëndim në distancë rreth 200 m në vijë ajrore kalon rruga “Fan Noli”.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Zyra Postare Qendrore Pogradec (është e përbërë nga dy prona me certifikata të vecanta pasurie), ndodhet në katin përdhe dhe katin e parë të një godine 4 katëshe. Kjo godina është

ndërtim i viteve 1980. Godina është realizuar nga ana konstruktive me themele buto/betoni, mure masive mbajtës tullë e plotë, soletë monolite ndër kat, mbuluar me soletë të hidroizoluar. Fasada e jashtme është me vetratë xhami të fiksuar në konstruksion me profile duralumini, pjesa tjetër e kolonave b/arme është e suvatuar dhe e lyer, në gjendje shumë të mirë mirëmbajtjeje.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Aktiviteti i postës qendrore Pogradec, zhvillohet në katin përdhe dhe katin e parë të ndërtesës. Kati përdhe është i përbërë nga 1 ambjent pritës, 9 ambjente zyrash dhe 1 tualet, ndërsa kati i parë është i përbërë nga hollit i shkallëve, 4 ambjente zyrash një korridor dhe një tualet. Prona ka vite që i është nënshtruar rikonstruksionit megjithatë paraqitet në përgjithësi në gjendje jo të mirë.

Niveli i rifiniturave të ndërtesës është jo i mirë. Muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të bojatisur. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gresi dhe me plintusa përreth në ambjentet e zyrave ndërsa në hollin pritës, është më pllaka granili me motive.

Ambjenti i hollit i ndarë në disa ambjente, ku ambjenti i pritjes së klientëve zë hapësirën më të madhe, kurse ambjenti i shërbimit i ndarë me banak në formë L-je dhe në hapësirën e lartësisë mbi ½ të tij, vendosur xhama në profile duralumini, kurse në pjesën e sipërme ka tavan të varur me ndriçim.

Shkallët e brendshme të pronës, ato të hollit, janë në formë harkore, me pllaka granili, të siguruara me parrakë me profile hekuri të punuar me motive dekorative, kurse shkallët e ndërkatit, me bazamakë mermeri, të siguruar me parrakë hekuri të thjeshtë.

Vetratat e dritareve, përjashtuar ato të fasadës e cila është me vetratë xhami të fiksuar në konstruksion me profile duralumini, janë me profile duralumini dhe të mbrojtura me zgara hekuri. Dyert e brendshme janë me profile duralumini e xham, ndërsa disa prej tyre janë druri të amortizuara. Brenda korridorit të katit dytë dhe në një nga zyrat janë vendosur dyer me profile hekuri, të punuar me motive dekorative të thjeshta. Tualeti është i shtruar me pllaka gres dhe muret janë të veshura me pllaka majolike, por vihen re disa shenja të dëmtimit të suvasë nga lagështia.

Instalimet elektrike janë brenda murit për celësa e priza.





FOTOGRAFI TË PRONËS

Pamje të jashtme të pronës



Pamje të ambienteve të brendshme të pronës







FILIALI GJIROKASTËR :

1-ZYRA E FILIALIT GJIROKASTËR

Zyrat Postare me sip. ndërt. 143.0 m² , nr. Pas. 8/40 ndodhur në “Pazari i Ri” Gjirokastër.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona, objekt i vlerësimit tonë, është Zyra Postare me sip. ndërtimore 143.0 m² , nr. Pas. 8/40 ndodhur në lagjen “Pazari I Ri” Gjirokastër . Godina në të cilën ndodhet prona është ndërtuar në vitin 1986 dhe rikonstruktuar në vitin 2006, e cila ndodhet ne lagjen karakteristike të Qafës së Pazarit në veri me akses të drejtëpërdrejtë te Rrugës Qafa e Pazarit. Ndërtesa lokalizohet ne anen perendimore te qytetit në distancë rreth 40 m larg dhe në anën veriore te rruges Varrosh - Qafa e Pazarit; Prona ndodhet në distancë rreth 1.1 km ne perendim te sheshit te Lagjes “ 18 Shtatori “ në distancë rreth 280 m ne veriperendim te sheshit “ Çerciz Topulli “; Ne veri të pronës është Lagja “Palorto” dhe me tej prroi I Culles; Ne jug të pronës është Rruga karakteristike “Varrosh-Qafa e Pazarit; Ne perendim të pronës ndodhet godina e Keshillit te Qarkut dhe me tej rruga e Lagjes “Palorto “; Në distancë rreth 650 m ne lindje të pronës është Lagja “Varrosh”.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është Zyra Postare me sip. ndërtimore 143.0 m² ndodhur në lagjen “Qafa e Pazarit” ose “Pazari I Ri”, Gjirokastër . Godina në të cilën ndodhet prona është me 2 kate mbi tokë, ndërtuar në vitin 1986 dhe është rikonstruktuar në vitin 2006, e cila ndodhet ne lagjen karakteristike te rruges Qafa e Pazarit. Hyrja ne prone behet nga rruga kryesore Qafa e Pazarit të cilën e ka në jug, nepermjet shkalleve prej guri dhe harkut prej guri. Pjesa hyrese dhe rruga jane te shtruara dhe te veshura me pllaka gurri dhe te dekoruara me pllaka guri dekorative. Ndertesa ka konstruksion te kombinuar per themelet guri dhe b/arme dhe mure ne lartesi guri kombinuar me tulle. Fasadat e katit perdhe te ndertesës pjesërisht jane te veshura me gurte per katin perdhe dhe te suvatuara per katin e pare. Mbulimi eshte realizuar me solete dhe cati vendi e mbulese me tjegulla. Dritaret jane d/alumini nga brenda te veshura me dru nga jashte dhe rreth tyre te punuara me detaje dekorative karakteristike te zones. Porta e hyrjes ne ndertese eshte druri e rende dykanateshe e kombinuar me xham. Tarraca e objektit është në gjendje shumë të amortizuar dhe kati I dytë në të gjithë sipërfaqen e saj ka problem të theksuara lagështire për shkak të tarracës.

b) Përshkrimi i brëndshëm :

Në momentin e inspektimit konstatuam që të dykatet e godinës shërbenin ambiente të drejtorisë kryesore të Filialit Gjirokastër. I gjithë aktiviteti i postes zhvillohet në katin e përdhe e të parë të ndërtesës. Prona është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje. Prona është e përbërë nga ambientet e zyrave dhe ambiente ndihmëse. Prona ka në pronësi 143.0 m² ndërtesë. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura të amortizuara , me dysHEME të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesë anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyer. Vettratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me zgara metalik dekorative. Rrjeti elektrik është i amortizuar dhe i lidhur me

rrjetin kryesor të zonës. Rrjeti hidrosanitar është i amortizuar dhe ilidhur me rrjetin kryesor të zonës.





FILIALI LEZHË :

1-ZYRA KURBIN (LAÇ QENDËR)

Zyra Postare Laç me sip. 120 m², ndodhur në lagjen Nr.5, Posta Qendrore Laç-Qendër, Kurbin.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Laç, ne lagjen nr.3 te qytetit, ne pjesen qendore te tij.

Në veri me shesh, rruge dhe Tirana Bank;

Në jug me kufizohet me pallate banimi e sherbimi;

Në lindje rrugë kryesore me asfalt;

Në perëndim kufizohet me rruge dhe kompleks banimi;

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Gjendet ne bulevardin e Lacit, ne anen jugore te tij. Eshte nje ndertese e perbere nga tre kate me themele te vazhduara dhe me forme drejkendeshe. Ne pjesen e jashtme ka mure te suvatuara dhe te lyera me boje te verdhe. Ato paraqiten me demtime te shumta por jo madhore, prezence te lageshtise ne pjesen e siperme dhe te poshme te postes. Jane te vendosura edhe ulluqe per largimin e ujrave nga soleta te cilat jane te amortizuara dhe kane nevojë per mirembajtje. Eshte e plotesuar me dyer dhe dritare me vetrata duralumini, te mbuluara me kangjella hekuri dhe qepen metalik ne forme rrjete vetem ne nje pjese se nderteses. Jane te vendosura dhe dy kuti postare por mungon reklama e postes. Nga jashte objekti ruhet me sisteme monitorimi (kamera).

b) Përshkrimi i brendshëm :



Pjesa e brendshme e godinës ka vite që nuk është e rikonstruktuar dhe e gjithë infrastruktura e brendshme (elektrik, hidraulik, shtrim pllakash, dyer, dritare, etj.) është e amortizuar.

Kati I: Salle shërbimi e madhe, shtatë dhoma pune, sherbimi per punonjesit dhe dy banjo.

Kati II: Perbehet nga dy sallone dhe kater zyra sherbimi.

Bodrumi është i pandarë. Ne pjesen e brendshme (kati i pare), holli i prites per publikun është i ndarë në mes me nje mur në formë gjysëmrrrethi, i veshur me pllaka prej mermeri dhe në lartësi ka kasa duralumini dhe xhami. Dyshemeja eshte e shtruar me pllaka porcelani dhe gresi me demtime ne vende te ndryshme. Gjithashtu, muret e brendshme jane te suvatuara, te lyera me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence te larte lageshtije ne secilin kat me e theksuar ne katin e trete). Tavani i nderteses ka shenja te dukshme te lageshtires dhe mykut sidomos ne katin e trete. Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Baza materiale e punes nuk eshte e plote gjithesesi, ajo që është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjetëruar Shtresat e brendshme te dyshemeve dhe shkalleve jane te shtruara me pllake. Shkallet jane te pajisura me parrakë metalikë.





2- ZYRAT FILIALI LEZHË. DEGA MIRDITË-QENDËR

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Posta Qendrore Rrëshen me sip. 120.25 m², ndodhur në Sheshin “Gjergj Fishta ndodhet në qytetin e Rrëshenit, ne Sheshin “Gjergj Fishta”. Ajo kufizohet ne dy ane me rruget kryesore te qytetit dhe ne dy anet e tjera me Alblekomin. Prona perbehet nga nje salle pritje ,salle pune,2 dhoma te boshatisura,korridor, 4 zyra pune dhe ËC.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona është e vendosur në katin e pare të një pallati 6-katesh. Ndërtesa ne pjesen e jashtme eshte e suvatuar dhe e lyster,dera kryesore eshte me kafaz hekuri,gjithashtu dhe dritaret jane me zgara hekuri dhe me qepena. Kjo prone ka dy hyrje, nje hyrje per administraten dhe nje hyrje per klientet. Viti i ndertimit eshte 1985.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Dyshemeja eshte e shtruar me pllaka porcelani dhe gresi me demtime ne vende te ndryshme. Gjithashtu, muret e brendshme jane te suvatuara, te lyster me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence te larte lageshtije ne secilin kat). Tavani i nderteses ka shenja te dukshme te lageshtires dhe mykut . Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Baza materiale e punes nuk eshte e plote gjithesesi, ajo që është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjeteluar si dhe e gjithë infrastruktura e brendshme(elektrik,hidraulik,shtrim pllakash,dyer,dritare,etj).Ambjentet e zyrave te administrates jane pjeserisht me lageshtire dhe disi te amortizuara.Dera kryesore e administrates eshte prej druri dhe e mbrojtur me kafaz hekuri.Dritaret jane me vetrata duralumini dhe xhama,te mbrojtura me kafaz hekuri.

Ambjentet e brendshme te zyrave te sherbimit jane tejet të amortizuara. Sporteli eshte me vetrata duralumini dhe xhame ne pjesen e sipërme dhe me mur i veshur me mermer ne pjesen e poshtme.



FILIALI BERAT :

1-ZYRAT FILIALI BERAT-ZYRA POSTARE URA VAJGURORE

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare ndodhet, me sipërfaqe 56 m², me nr. 2/305-N3 pasurie, ndodhur në lagjen “18 Tetori”,Ura Vajgurore. Prona ndodhet në zonën qendrore të qytetit, në anën jugperëndimore të sheshit kryesor dhe në veri të lumit Osum. Në perëndim prona kufizohet me rrugë dhe më tej me ndërtesë 3-katshe dhe rreth 300 m është ura e Osumit, kurse në lindje janë ambiente të Albtelekomit dhe ndërtesa. Zona ku ndodhet prona është kryesisht zonë urbane, ekonomikisht me prosperitet dhe në rritje, të një niveli të mesëm ekonomik, me përdorim mikës. Përreth tij ndodhen pallate banimi, lokale shërbimi, dyqane. Akses i pronës është i mirë, direkt nga sheshi kryesor i qytetit. Infrastruktura dhe rrugët janë në gjëndje të mirë, pajisur me ndriçim rrugor, trotuare të shtruara me pllaka betoni.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm:

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është njësi në katin e parë të ndërtesës 2-katshe, me sipërfaqe ndërtesë 56 m², e cila është ndërtuar në vitin 1980. Prona është e ndërtuar mbi themele guri dhe ka konstruksion me mure tulle të plotë me trashësi 25 cm, nën një mbulesë me soletë e cila paraqitet në gjendje normale. Fasada është e suvatuar dhe e lyer në gjendje të mesatare. Posta ndodhet në anën perëndimore të sipërfaqes së katit përdhe. Ajo ka akses të drejtpërdrejtë në anën veriore të saj, me trotuarin dhe sheshin kryesor, kurse në anën lindore me ambientet e Albtelekomit. Hyrja në të realizohet nga ana veriore e sipërfaqes, nëpërmjet një porte dy kanatëshe duralumin e xham dhe me qepen metalik.

b) Përshkrimi i brendshëm:

Ambjentet e brendshme janë shtruar me pllaka porcelani dhe gresi me demtime ne vende te ndryshme. Gjithashtu, muret e brendshme jane te suvatuara, te lyera me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezenca te larte lageshtije ne secilin kat). Tavani i nderteses ka shenja te dukshme te lageshtires dhe mykut. Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Baza materiale e punes nuk eshte e plote gjithesesi, ajo qe është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjetëruar Ajo është e përbërë nga ambientet e sporteleve të shërbimit, koridori hyrës, ambientet e dy zyrave dhe tualeti.Veshja e banakut të sportelit është realizuar me pllaka të amortizuara dhe dalë boje.Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena metalik. Hyrja kryesore realizohet nga ana veriore me derë duralumin dy kanatëshe dhe me qepen metalik. Tualeti është i kompletuar me paisje të thjeshta por tejet të amortizuara. Furnizimi me energji elektrike dhe ujë realizohet nga rjetet përkatëse të zonës. Shkarkimet e ujrave bëhen në kolektorin kryesor. Prona është e paisur edhe me sistem vëzhgimi me kamera.



2- ZYRAT FILIALI BERAT. DEGA KUÇOVË-ZYRA POSTARE Nr.1

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra Postare Nr.1, me sip.74 m2, e ndodhur në katin përdhe, të një ndërtese 5-katëshe shërbimi e banimi, në Lgj.”5 Qershori”, Kuçovë.Në veri prona kufizohet me disa pallate 5 katësh dhe ne distancë rreth 310 m ndodhet kinemaja “Kadri Roshi”. Në jug prona kufizohet me rrugën “5 Qershori” dhe më tej gjendet në distancë rreth 200 m ndodhet Ish Uzina Mekanike. Në lindje prona kufizohet me një ndërtesë tjetër dhe në distancë rreth 40 m kalon Rruga e Re. Në Perëndim prona kufizohet me një pallat 5 katësh dhe në distancë rreth 250 m në vijë ajrore kalon rruga “ Stanislav Zuber”. Komunikimi me rrugën kryesore nacionale realizohet nëpërmjet një rruge të shtruar me cakëll në anën jugore.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Pershkrimi i jashtëm :

Njësia është pjesë e një pallati të ndërtuar rreth viteve 1980 dhe ndodhet në katin përdhe të saj. Ndërtesa ka konstruksion me themele të vazhduara, me mure perimetral tulle, solete me traveta. Tarraca e objektit është në gjendje shumë të amortizuar në të gjithë sipërfaqen e ambienteve të saj ka problem të theksuara lagështire për shkak të tarracës.

b)Përshkrimi i brendshëm :Pjesa e brendshme- muret e brendshme jane te suvatuara, te lyera me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence te larte lageshtije ne secilin kat). Tavani i nderteses ka shenja te dukshme te lageshtires dhe mykut . Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Baza materiale e punes nuk eshte e plote gjithesesi, ajo qe është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjeteruar si dhe e gjithe infrastruktura e brendshme(elektrik,hidraulik,shtrim pllakash,dyer,dritare,etj). Zyra është e përbërë nga 1 ambjent sporteli, 2 zyra dhe një tualet. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gres dhe e pajisur me plintues. Dyert e brendshme janë druri tamburato të amortizuara. Dritaret janë me profile duralumini. Dritaret dhe dera e jashtme janë të pajisur edhe me qepen metalik dhe zgara mbrojtëse.Ambjentet e zyrave te administrates jane pjeserisht me lageshtire dhe disi te amortizuara.Dera kryesore e administrates eshte prej druri dhe e mbrojtur me kafaz hekuri.Dritaret jane me vetrata duralumini dhe xhama,te mbrojtura me kafaz hekuri por të amortizuara dhe me demtime.





3-ZYRAT FILIALI BERAT. DEGA SKRAPAR- ZYRA POSTARE ÇOROVODE - QENDER

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyrat Postare me sip. ndërtimore 69 m² dhe sip. trualli 94 m², me Nr. 5/13-N1 pasurie

Zyrat Postare me sip. ndërtimore 176 m² dhe sip. trualli 176 m², me Nr. 5/13-N6 pasurie

Zyrat Postare me sip. ndërtimore 35 m² dhe sip. trualli 35 m², me Nr. 5/13-N9 pasurie

Zyrat Postare me sip. ndërtimore 46.7 m², me Nr. 5/13-N10 pasurie Zyrat Postare me sip. ndërtimore 82 m² dhe sip. trualli 82 m², me Nr. 5/13-N7 pasurie

Zyrat Postare me sip. ndërtimore 195 m², me Nr. 5/13-N8 pasurie Zyrat Postare me sip. ndërtimore 43.5 m², me Nr. 5/13-N11 pasurie ndodhur në lagjen “Çlirimi”, Çorovodë, Skrapar. Zyra Postare qendrore ndodhen në qytetin e Çorovodës, në Pall. 6, Lagjia “Çlirimi”, në verilindje të sheshit kryesor të qytetit. Në perëndim prona kufizohet me rrugën “Sadush Myftari”, kurse nga ana lindore kufiohet me rrugën “Arkitekt Sinani” që shkon në Gjerbës. Në jugperëndim, rreth 80 m ndodhet gjykata e rrethit, rreth 110 m është godina e Bashkisë dhe Qendra Kulturore, kurse nga ana veriore kalon një rrugë dhe më tej janë ndërtesat e hoteleve “Flora” e “Kalemi”, si dhe ndëretesa të tjera banimi. Pronat ndodhen në katin bodrum, përdhe, të parë dhe të dytë të një pallati 5-katësh, me nr.6.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Pershkrimi i jashtëm :

Pronat, objekt i këtij vlerësimi, janë vendosur në katin bodrum, përdhe, të parë dhe të dytë të një ndërtese 5-katshe, me funksion miks, me ambiente tregëtare, zyra, operacionale, e

ndërtuar në viteve 1980. Ndërtesa ka konstruksion te kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm per muret e jashtme e te brendshme. Kati bodrum i ndertesës ka konstruksion mure,solete dhe dysHEME b/arme te hidroizoluuar nga tre ane. Arkitektura e jashtme e ndertesës eshte tip e viteve te ndertimit, ne pershtatje me destinacionin e objektit dhe te ndertesave perreth te ndertuara ne vitet 70-80-te. Fasada e katit përdhe eshte e suvatuuar dhe e lyster, kurse në lartësi pallati është i pasuvatuuar. Dritaret dhe vetratat jane profile duralumini e xham, dhe ato te katit përdhe te siguruara me zgara mbrojtese e qepena metalik. E gjithë ndërtesa eshte e ngritur mbi platformen e bodrumit. Ndërtesa ka hyrje kryesore me shkalle masive ne anen jugore te saj per ne katin përdhe ku behen sherbimet me klientin dhe hyrje ne anen veriore, e cila nepermjet shkalleve te jashtme realizon komunikimin midis kateve. Trotuari para pronës eshte i shtruar dhe i sistemuar. Ne prone hyhet direkt nga sheshi qëndror.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Prona 5/13-N6 me sipërfaqje ndërtimore 176 m² dhe sipërfaqe trualli 176 m², është në anën juglindore të godinës dhe ndodhet në katin bodrum. Nga brenda perbehet nga tre ambiente bodrumi, të cilat janë jashtë funksionimit. Keshtu dysHEmete e ambienteve jane te shtruara me beton dhe këto ambiente janë pa dyer dhe një dritare të dëmtuar.

Prona 5/13-N9 me sipërfaqje ndërtimore 35 m² dhe sipërfaqe trualli 35 m², ndodhet në katin bodrum, në anën jugperëndimore të godinës dhe është magazina. Hyrja realizohet me shkallë zbritëse nga ana veriore e godinës. Nga brenda perbehet nga një ambient bosh, jashtë funksionit. Eshtë një ambient pa dyer e dritare, por të mbrojtura me zgara metalike.

Prona 5/13-N1 me sipërfaqje ndërtimore 69 m² dhe sipërfaqe trualli 90 m², ndodhet në katin përdhe (i parë) është në anën juglindore të godinës dhe janë zyrat e shërbimit. Nga brenda perbehet nga dy ambiente zyrash dhe një tualet. Muret e brendshme jane te suvatuara, te lyster me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence te larte lageshtije ne secilin kat). Tavani i ndertesës ka shenja te dukshme te lageshtires dhe mykut . Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Ajo që është konstatuar gjatë inspeksionit, paraqitet me demtime dhe e vjetëruar si dhe e gjithë infrastruktura e brendshme(elektrik,hidraulik,shtrim pllakash,dyer,dritare,etj. Keshtu dysHEmete e ambienteve jane te shtruara me pllaka gresi, muret dhe tavanet jane te suvatuara dhe te lyster. Banaku është i veshur me melamine. Vetratat dhe dritaret jane profile duralumini me xham dhe të mbrojtura me qepena metalike.

Prona 5/13-N7 me sipërfaqje ndërtimore 82 m² dhe sipërfaqe trualli 82 m², ndodhet në katin e parë (të dytë) është në anën veriore të godinës dhe janë zyrat e pensionit. Nga brenda perbehet nga salla e klientëve, zyra e llogarisë, zyra e shefit dhe tualeti. Ky ambient nuk eshte i rikonstruktuar dhe paraqitet ne kushte tejet të amortizuar. Keshtu dysHEmete e ambienteve jane te shtruara me pllaka gresi, muret dhe tavanet jane te suvatuara dhe te lyster por të dala boje dhe të ciflosura. Banaku është i veshur me melamine. Vetratat dhe dritaret jane profile duralumini me xham dhe të mbrojtura me zgara metalike.

Prona 5/13-N10 me sipërfaqje ndërtimore 46.7 m² dhe sipërfaqe trualli 46.7 m², ndodhet në katin e parë (të dytë) është në anën jugperëndimore të godinës dhe janë zyrat e shërbimit mandat pagesave. Nga brenda perbehet nga salla që shërben si sallë klientësh dhe dhoma e sigurisë. Ky ambient nuk eshte i rikonstruktuar dhe paraqitet ne kushte tejet të amortizuar.

Keshtu dyshemetete e ambienteve jane te shtruara me pllaka gresi, muret dhe tavanet jane te suvatuara dhe te lyera por ka prani të theksuar lagështije dhe myku. Banaku është i veshur me melamine. Vettratat dhe dritaret jane profile duralumini me xham dhe të mbrojtura me zgara metalike. Dera e ambientit të sigurisë është e blinduar.

Prona 5/13-N11 me sipërfaqje ndërtimore 43.5 m² dhe sipërfaqe trualli 43.5 m², ndodhet në katin e dytë (të tretë) është në anën jugperëndimore të godinës dhe është zyra e drejtorit dhe zyra e financës. Nga brenda perbehet nga një ambient, që është jashtë funksionit. Dyshemetë janë shtruar me pllaka çimento. Dyert e dritaret janë druri të amortizuara.

Prona 5/13-N8 me sipërfaqje ndërtimore 195 m² dhe sipërfaqe trualli 195 m², ndodhet në katin e dytë (të tretë) është në anën jugperëndimore të godinës dhe janë bosh. Nga brenda perbehet nga gjashtë zyra dhe koridori, të cilat janë jashtë funksionit. Dyshemetë janë shtruar me pllaka çimento. Dyert e dritaret janë druri të amortizuara.

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga rrjeti i zonës. Instalimet elektrike janë normale në ambientet funksionalë dhe të amortizuar në ambientet e tjerë. Furnizimi me ujë bëhet nga rrjeti i ujësjellësit të zonës. Në ambientet e shërbimit të katit bodrum dhe përdhe ka edhe sistem vëzhgimi me kamera.





4-ZYRAT FILIALI BERAT. DEGA KUÇOVË - ZYRA POSTARE POLIÇAN

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyrat Postare N1 me sipërfaqe 50 m², me nr. 12/306-N3 (18) pasurie, ndodhur katin e parë të ish MAPO, në Poliçan, Skrapar ndodhet në Poliçan Qendër të Skraparit. Prona ndodhet buzë rrugës “Miqësia” në anën perëndimore të sheshit qendror të Poliçanit. Në veriperëndim të pronës, rreth 100 është spitali, dhe më tej ndodhet Bashkia, ndërsa në perëndim, rreth 150 m ndodhet shkolla “70 Vjetori Pavarësisë”. Në verilindje, rreth 120 m, ndodhet xhamia, ndërsa në lindje rreth 100 m, është rruga Lulaj.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona është një njësi e cila ndodhet në patin përdhe të një pallati 3-katsh, në pjesën qendrore të godinës. Godina është ndërtuar rreth viteve 80', me konstruksion themele guri e mure tulle të plotë të kombinuar me breza betoni, e mbuluar me kapriatë druri e cati tjegull. Fasada rreth pronës është e suvatuar dhe rikonstruktuar vitet e fundit. Hyrja për në pronë realizohet nga sheshi kryesor para ndërtesës, nga ana lindore e saj.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Prona ka sipërfaqe 50 m² dhe përbëhet nga një ambient shërbim klientele me banakun si dhe një ambient për kasafortën dhe arshivën. Ky objekt nuk është i rikonstruktuar dhe paraqitet në kushte tejet të amortizuara. Ambientet e brendshme të pronës, janë me rifinitura, me dysheme të shtruara me pllaka çimento dhe të pajisur me plintues anësor përgjatë mureve por të dala boje dhe të ciflosura. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyster por ka prezencë myku dhe lagështie. Dera kryesore e hyrjes është duralumin një kanatëshe. Vetratat e dritareve dhe dera e kasafortës janë me profile duralumini me xham por tejet të vjetra. Instalimet elektrike janë të vjetra por funksionojnë ndërsa lidhjet hidraulike janë pothuaj jashtë funksionit. Prona është e paisur edhe me sistem vëzhgimi me kamera.





FILIALI ELBASAN :

1-ZYRAT FILIALI ELBASAN - DEGA LIBRAZHD, ZYRA POSTARE PPRENJAS

VENDODHJA E OBJEKTIT

Zyra postare me sip. 43.2 m², me nr. 2/138-N2 pas, ndodhet qytetin e Prenjasit Prona ndodhet në qendër te qytetit te Prenjasit, rreth 200 m në veri të rrugës nacionale, rreth 120 m në juglindje të Pallatit të Kulturës, 200 m në jug të shkollës 9-vjecare dhe përgjatë anës lindore të bulevardit kryesor. Në veri bulevardi “ Rinia “ dhe më tej pallate 3 dhe 5-kateshe dhe busti “Minatori “, kurse në jug lulishte, pallate nga dy deri në 5-katëshe dhe më tej rruga nacionale Tirane -Korce. Në lindje lulishte dhe pallate 5-kateshe, rreth 150 m Unaza e qytetit, kurse në perëndim rruga hyrese kryesore, sheshi i ri, rreth 100 m zyra e Pensioneve dhe rreth 400 m Gjumnazi i qytetit.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE


a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është një njësi, që ndodhet në katin përdhe të një pallati 5-katesh, i ndertuar ne vitin 1972. Hyrja kryesore në pronë bëhet nga ana perendimore direkt nga bulevardi “Rinia”. Pallati ku ndodhet prona ka konstruksion me themele buto/betoni, mure perimetralë e ndarës tulle, soleta nderkati b/arme monolite, mbuluar me soletë të hidroizoluar.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Ambientet e brendshme te Postes shërbejnë për pritjen dhe shërbimin e klientëve si dhe ambjente pune. Hyrja në ambjente bëhet direkt nga srruga kryesore, nëpërmjet një dere dy kanatëshe me vetrata me profile duralumini dhe xhama. Dyert e ambjenteve të brendshme pjesërisht janë tamburato e pjesërisht janë me profile duralumini. Dritaret jane duralumin. Ambientet e brendshme të pronës, janë me rifinitura, me dysheme të shtruar me pllaka gres dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve por të dala boje dhe të ciflosura. Muret dhe tavanet janë të suvatuara dhe të lyer por ka prezencë myku dhe lagështie. Dera kryesore e hyrjes është duralumin një kanatëshe. Vetratat e dritareve janë me profile duralumini me xham por tejet të vjetra. Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Prona është e paisur edhe me sistem vëzhgimi.





FILIALI TROPOJE :

1-ZYRA POSTARE ME SIPËRFAQE 61 M², NDODHUR NË BAJRAM CURRI, TROPOJË.

A- VENDNDODHJA

Zyra Postare e pensioneve me sipërfaqe 61 m² ndodhet në qytetin e Bajram Currit. Në veri të pronës, rreth 30 m, është sheshi “Azem Hajdari”, dhe më tej rreth 120 m, është sheshi “Dardania”. Në veri të pronës, rreth 20 m, është rruga “Ram Sadria, ndërsa në veriperëndim, rreth 70 m, është Bashkia e qytetit. Në jug, rreth 15 m, është rruga “Mic Sokoli”, dhe më tej truall i lirë.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Për pronën Zyrat Postare me sipërfaqe 61 m², ndodhur në Bajram Curri, Tropojë më poshtë po japim një përshkrim të pjesës së jashtme dhe të brendshme të saj:

a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi, është kati përdhe i një pallati 6-katsh, e ndërtuar në vitet 80', ku bëhet ndarja e pensioneve. Ndërtesa ka konstruksion te kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm per muret e jashtme e te brendshme. Fasada e ndërtesës është e suvatuar, dhe e lyer. Dera e jashtme është hekuri, dhe e siguruar me kangjella metalike. Ndërtesa ka hyrje kryesore në anën perëndimore të saj, direkt nga sheshi i brendshëm i pallatit, ku behen edhe shërbimet me klientin, si dhe zyrat e administratës. Trotuari para pronës është i shtruar dhe i sistemuar.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Aktiviteti kryhet kryhet në katin përdhe të një pallati 6-katsh, e cila nga brenda përbëhet nga ambientet e shërbimit të klientit për pensionet, ambientet e zyrave, tualeti, depo dhe koridori. Ambientet janë të rikonstruktura dhe paraqiten në kushte e gjendje te mire mirembajtje. Dyshemeja e te gjitha ambienteve është e shtruar me pllaka gresi. Ambientet e brendshme të pronës muret dhe tavanet u ka rënë komplet suvaja dhe ka prezencë të theksuar myku dhe lagështie. Dera kryesore e hyrjes është duralumin një kanatëshe.. Instalimet elektrike janë te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike janë jashte funksionit. Banaku i sportelit të shërbimit pensioneve është me material melaminë e me vetratë duralumini, si dhe kangjella metalike tejet të amortizuara.





FILIALI FIER :

1-ZYRAT FILIALI FIER - ZYRAT POSTARE ROSKOVEC

Pasuritë e Paluajtshme (Truall+Ndërtesë) Zyra Postare me sipërfaqe ndërtimore 17.0 m² ndodhur në qytezën e Roskovecit, të rrethit të Fierit. Zyra Postare me sipërfaqe ndërtimore 19.0 m² ndodhur në Qytezën e Roskovecit, të rrethit të Fierit.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Pronat ndodhen në qytezën e Roskovecit të rrethit të Fierit. Pronat ndodhen rreth 10 km larg në vijë ajrore, në anën lindore të qytetit të Fierit. Pronat ndodhen në qendër të qytezës së Roskovecit, në anën perëndimore të rrugës kryesore të qytetit, në akses të drejtpërdrejtë me të. Në veri të pronave ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi e shërbimesh. Në jug të pronës, në akses të drejtpërdrejtë me të, kalon rrugë e asfaltuar e lagjes dhe në vazhdim rreth 60 m larg në vijë ajrore, ndodhet godina e Shkollës "Adem Vrapit". Në lindje të pronës, në akses të drejtpërdrejtë me të, kalon rruga kryesore e qytetit. Në perëndim të pronës, ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi e shërbimesh. Akses i drejtpërdrejtë nga rruga kryesore e cila është në gjendje dhe kushte të mira mirëmbajtjeje;


B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Godina në të cilën ndodhen pronat, është një ndërtesë 4 katëshe banimi e shërbimesh, me konstruksion beton arme, mure tulle, mbuluar me soletë monolite. Ndërtesa nga jashtë është e pa suvatuar dhe e pa lyer.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Njësitë me sip. 17.0 m² dhe 19.0 m² ndodhen në katin përdhe të ndërtesës 4 katëshe, në krah të njera-tjetrës. Një njësi shërben si zyrë postare, ndërsa tjetra, shërben si zyrë për ndarjen e pensioneve. Të dyja pronat paraqiten në gjendje dhe kushte tejet të amortizuar për shkak se aty nuk është investuar për një kohë të gjatë.. Ato janë rikonstruktuar rreth dhjetëvjeçarit të fundit. Pronat janë të përbëra nga ambienti i sportelit të shërbimi + ambiente ndihmëse. Ambienti sportelit me sallën e klientëve, në të dy njësitë është i ndarë me një banak me material druri. Ambientet e brendshme të pronës janë me rifinitura normale, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve. Muret dhe tavaja ka rënë dhe ka prezencë të theksuar lagështie dhe myku. Pjesët fundore të mureve të çara, e pothuaj të shkëputura nga dyshemeja, për shkak të ngarkesave dinamike që veprojnë në themel. Vetratat e dritareve dhe dyerve janë me profile duralumini me xham. Ato janë të mbrojtura me qepena metalik. Instalimet elektrike dhe hidraulike janë të vjetra dhe tejet të amortizuara. Hyrja në të dyja pronat realizohet nga ana lindore e godinës, direkt nga trotuari i rrugës kryesore të zonës.



2-ZYRAT FILIALI FIER-POSTA Nr.1

Pasuritë e Paluajtshme (Truall+Ndërtesë) Zyra postare me sip. ndërtimore 67.42 m2, ndodhur në katin përdhe të ndërtesës, në lagjen “15 Tetori”, Fier.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Fierit 113 km në jug të Tiranës, në pjesën qendrore të qytetit, rreth 80 km larg në vijë ajrore. Prona ndodhet në Lgj.”15 Tetori”, në anën veri-perëndimore të sheshit kryesor të qytetit të Fierit “Sheshi Europa Plaza”. Rreth 80 m larg tij janë edhe Procredit Bank, Emporiki Bank, Hotel “Fieri” dhe objekte të tjera të rëndësishme të këtij qyteti. Në veri-lindje të saj, rreth 140 m larg në vijë ajrore, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, rreth 200 m kalon Bulevardi “Ramiz Aranitasi”, kurse në veri rreth 400 m kalon Rruga “M. Ulqinaku”, ku ndodhet edhe Shkolla “J. Xoxa”. Në anën jugore të pronës, në akses të drejtpërdrejtë me të, kalon rruga “Rauf Nallabani”. Në lindje të zyrës postare kalon rruga “Kastriot Muço”, me akses të drejtpërdrejtë me të dhe në vazhdim ndodhen ndërtesa të ndryshme banimi dhe shërbimi.

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE


a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi ndodhet në katin përdhe të ndërtesës me 5 kate mbi tokë ku kati përdhe është me ambiente shërbimi ndërsa katet e sipërme janë me apartamente banimi, e cila është ndërtuar rreth viteve 80’.

Ndërtesa ka konstrukcion me kollona betonarme me mure me tullë të plotë me trashësi të mureve të jashtme dhe atyre të brendshme 25 cm, nën një mbulesë me soletë monolite të hidroizoluara. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet pronë, është e pa suvatuar dhe ljer aksesit drejtpërdrejtë nga rruga publike.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Prona nuk është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në kushte dhe gjendje jo të mirëmbajtje. Sipërfaqja e brendshme e tij, përbëhet nga ambjent i cili shërben për pritjen dhe shërbimin e klientëve, ambiente pune si dhe një tualet. Hyrja në ambiente bëhet direkt nga sheshi kryesor i qytetit. Vetratat nga hyrja kryesore nuk janë të mbrojtura me grila metalike dhe janë pjesë e fasadës kolonat e të cilës janë me veshje graniti. Ambjenti i shërbimit është një sallë e madhe, e ndarë me një banak me material druri në formë L-je, sipër të cilit ka profile duralumini me xham. Dyert e ambjenteve të brendshme pjesërisht janë tamburato e pjesërisht janë me profile duralumini të demtuara dhe të amortizuara. Dritaret janë duralumin. Dyshemeja në të gjitha ambjentet, është e shtruar me pllaka gres njëngjyreshe, dhe me plintusa përgjatë perimetrit të mureve. Pllakat janë të ciflosura dhe të dala boje Tualeti është i shtruar me pllaka gres njëngjyreshe dhe me pllaka majolike në lartësi rreth 160cm të mureve, si dhe me paisje hidrosanitare si lavaman e wc në gjendje jo të mirë dhe të amortizuara. Instalimet elektrike janë brenda murit më vehte për celësa e priza por rrjeti paraqitet tejet i amortizuar dhe me probleme.



3-ZYRAT FILIALI FIER-POSTA Nr.2

Pasuritë e Paluajtshme (Truall+Ndërtesë) Zyra postare me sip. 76.4 m², ndodhur në katin përdhe të ndërtesës në lagjen “K.Fierit”, Fier.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në qytetin e Fierit 113 km në jug të Tiranës, në pjesën jugore të qytetit, rreth 1 km larg në vijë ajrore. Prona ndodhet në veri-lindje të “Q.T.Gold Center” rreth 100 m larg në vijë ajrore. Në veri prona kufizohet me ndërtesa 3-5 katëshe ekzistuese; Në jug me rrugën “Nuredin Aliu”; Në lindje prona kufizohet me ndërtesa 3-5 katëshe ekzistuese; Në perëndim ndërtesë 1 dhe 3-katëshe dhe rruga “Ramiz Arianitasi.


B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi ndodhet në katin përdhe të ndërtesës 5 katësh banimi dhe shërbimi, e cila është ndërtuar rreth viteve 80'. Ndërtesa ka konstruksion me kollona betonarme me mure me tullë të plotë me trashësi të mureve të jashtme dhe atyre të brendshme 25 cm, nën një mbulesë me soletë monolite të hidroizoluara. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet prona është e suvatuar dhe e lyster, në kushte dhe gjendje shumë jo të mirë mirëmbajtjeje.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Prona nuk është e rikonstruktuar kohët e fundit dhe paraqitet në kushte dhe gjendje jo të mirë mirëmbajtjeje. Sipërfaqja e brendshme e tij përbëhet nga një ambjent i cili shërben për pritjen dhe shërbimin e klientëve, si dhe ambjente të tjera pune e tualet. Hyrja në ambjente bëhet direkt nga sheshi kryesor nëpërmjet vetratave me profile duralumini dhe xhama. Muret e brendshme janë të suvatuar, të lyster me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence të lartë lageshtije. Tavani i ambjentit ka shenja të dukshme të lageshtires dhe mykut . Instalimet elektrike janë të vjetra por funksionojnë ndërsa lidhjet hidraulike janë pothuaj jashtë funksionit. Ajo që është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe të vjetëruar si dhe të gjithë infrastruktura e brendshme(elektrik,hidraulik,shtrim pllakash,dyer,dritare,etj. Kështu dyshemetë e ambienteve janë të shtruara me pllaka gresi, muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të lyster. Dyert e ambienteve të brendshme pjesërisht janë tamburato e pjesërisht janë me profile duralumini por të amortizuara. Dritaret janë duralumin.



FILIALI VLORE :

1-ZYRAT FILIALI VLORE. DEGA VLORE-ZYRA POSTARE Nr.2

Zyra Postare Nr.2 me sip.36m², me Nr.19/35-N1 pasurie dhe Ish Zyra Bankare aktualisht zyra e pensioneve, si dhe trualli në bashkëpronësi me sip.22m², në Lgj."24 Maji", Vlorë.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Pronat objekt vlerësimi janë zyrat e postës dhe ish zyra e bankës (Posta Çole Nr.2), të cilat ndodhen në qytetin e Vlorës, 100 km në jug të Tiranës, rreth 1 km në jugperëndim të qendrës, në lagjen "24 Maji". Prona ndodhet në anën veriore të Rrugës "Zaho Koka" dhe në anën perëndimore të Rrugës "Osman Hazhia", me akses të drejtpërdrejtë me to. Në anën lindore rreth 180 m kalon Rruga Transballkanike dhe rreth 750 m kalon Bulevardi i Pavarësisë, kurse në anën perëndimore rreth 200 m kalon Rruga "Mis Durhan". Në veri rreth 350 m larg kalon rruga "Enver Jaho" dhe rreth 450 m larg ndodhet Stacioni i trenit, kurse në jug kalon Rruga "Zaho Koka" dhe rreth 1 km larg është zona e Skelës.


B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Përshkrimi i jashtëm :

Pronat, objekt i këtij vlerësimi, ndodhen në katin përdhe të një ndërtese 5-katëshe, e ndërtuar rreth viteve 80', në anën juglindore të sipërfaqes së këtij kati. Ndërtesa ka konstruksion te kombinuar kollona, trare dhe soleta b/arme me mur tulle me trashësi 25 cm dhe 12 cm për muret e brendshme. Arkitektura e jashtme e ndërtesës është në përshtatje me destinacionin e objektit dhe të ndërtesave përreth të ndërtuara në vitet 70-80-të. Fasada e pallatit është e suvatuar dhe e lyer. Vettratat dhe dyert e jashtme jane profile duralumini e xham, dhe të siguruara me qepena metalike por tejet të amortizuara. Momentalisht posta përbëhet nga dy pjesë: posta me sip 36 m² dhe ish zyra bankare me sip 22 m², të cilat kanë dyer të vecanta hyrje dhe një derë lidhëse midis tyre. Posta ndodhet në anën jugore të ish zyrës bankare dhe të dyja funksionojnë për aktivitetin e postës. Posta ka hyrje kryesore në anën jugore të pallatit, direkt nga rruga "Z. Koka", nëpërmjet një shkalle betoni dhe një porte duralumin dy kanatëshe me qepen metalik, ku behen edhe shërbimet me klientin dhe është arkiva. Ndërsa ish zyra bankare ka hyrje të veçantë nga ana lindore, me lidhje me rrugën "O. Hazhiu" nëpërmjet një porte duralumin dy kanatëshe me qepen metalik. Trotuari para pronës është i shtruar dhe i sistemuar.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Sipërfaqia e postës 36 m² perbehet nga ambientet e shërbimit të klientit me banakun, arkiva, tualeti, kurse ish zyra bankare përbëhet nga një ambient i vetëm. Ambientet janë të pa rikonstruktuar dhe paraqiten në kushte të gjendje jo të mirë mirembajtje. Muret e brendshme jane te suvatuar, te lyera me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence te larte lageshtije ne secilin kat). Tavani i ndërtesës ka shenja të dukshme të lageshtires dhe mykut . Instalimet elektrike jane te vjetra por funksionojne ndersa lidhjet hidraulike jane pothuaj jashte funksionit. Ajo që është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjetëruar si dhe e gjithë infrastruktura e brendshme(elektrik,hidraulik,shtrim pllakash,dyer,dritare,etj. Prona është e paisur edhe me sistem vëzhgimi me kamer.



FILIALI DURRËS :

1-ZYRAT FILIALI DURRËS, DEGA DURRËS-ZYRA POSTARE DURRËS, Nr.5

Zyrat postare me sip.trualli 31.37m² dhe sipërfaqe ndërtese 31.37m² ndodhur në rrugën “K.Kazanxhi”/12, Durrës.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona objekt vlerësimi nga ana jonë është një godinë një katëshe e pozicionuar në anën Perendimore të rrugës “K.Kazanxhi” në ankesë të drejtperdrejte me të. Godina në të cilën ndodhet prona pozicionohet në anën veri-lindore të qendrës së qytetit të Durrësit rreth 1 Km larg në vijë ajrore. Në anën veriore të pronës ndodhen ndërtesa banimi dhe shërbimesh, rreth 60 m larg në vijë ajrore kalon rruga “Hysen Kërtusha” dhe në vazhdim rreth 600 m larg në vijë ajrore. Në anën veri-perendimore të pronës ndodhet Stadiumi i qytetit “Niko Dovana”. Në anën lindore të pronës në akses të drejtpërdrejtë me të kalon rruga “K.Kazanxhi”, Kaluar rrugën ndodhen ndërtesa egzistuese banimi si dhe ndërtesa të ndertuara këtu vitet e fundit dhe rreth 240 m larg në vijë ajrore ndodhet godina e shkolles “14 Nentori”. Në anën jugore të pronës në kufije me të ndodhet një godinë një katëshe dhe më tej kalon rruga “Marta Buda”. Në anën perëndimore të pronës ndodhet bllok me ndërtesa të ndryshme banimi.

B-PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE


a) Përshkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i vlerësimit tonë është një ndërtesë një katëshe me sip. Trualli dhe ndertimi prej 31.37 m². Ndërtesa ka konstruksion me kollona betonarme me mure me tullë, nën një mbulesë me soletë monolite të hidroizoluara. Fasada e ndërtesës në të cilën ndodhet prona është e suvatuar dhe e lyster, prona ndodhet në kushte dhe gjendje të mirë mirëmbajtjeje. Aksesit direkt nga rruga publike.

b) Përshkrimi i brendshëm :

Prona nuk është e rikonstruktuar vitet e fundit dhe paraqitet në kushte dhe gjendje relativisht jo të mirë mirëmbajtjeje. Sipërfaqja e brendshme e pronës, përbëhet nga një ambjent i cili shërben për pritjen dhe shërbimin e klientëve si dhe ambjente pune. Hyrja në ambjente bëhet direkt nga sheshi kryesor nëpërmjet një porte me profile duralumini dhe xhama. Vettrat nga hyrja kryesore janë të mbrojtura edhe me qepen metalike. Dyert e ambjenteve të brendshme janë me profile duralumini të amortizuara. Dritaret janë me profile duralumini. Dyshemeja në të gjitha ambjentet është e shtruar me pllaka gres njëngjyrëshe, dhe me plintusa përgjatë perimetrit të mureve. Muret e brendshme janë të suvatuara, të lyster me boje, por me demtime, plasaritje dhe prezence të lartë lageshtije në secilin kat). Tavani i ndërtesës ka shenja të dukshme të lageshtires dhe mykut . Ajo që është konstatuar gjatë inspektimit, paraqitet me demtime dhe e vjetëruar si dhe e gjithë infrastruktura e brendshme (elektrik, hidraulik, shtrim pllakash, dyer, dritare, etj. Banaku është i veshur me melamine por tejet i amortizuar. Vettrat dhe dritaret janë profile duralumini me xham dhe të mbrojtura me qepena metalike.

Instalimet elektrike janë të vjetra por funksionojnë ndërsa lidhjet hidraulike janë pothuaj jashtë funksioni



FILIALI SARANDE :

1-ZYRAT FILIALI SARANDË-ZYRA POSTARE ALIKO.

Zyrat postare Aliko, me sipërfaqe ndërtimore 98², me sipërfaqe trualli 138m², ndodhur në Aliko, Bashkia Finiq, Sarandë.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT

Prona ndodhet në fshatin Aliko rreth 276 km në jug të Tiranës, 129 km në jug të qytetit të Vlorës dhe rreth 4 km në lindje të qytetit të Sarandës. Prona ndodhet në qendër të fshatit, rreth 60 m në lindje të godinës së Komunës. Në perëndim, rreth 10 m larg, është sheshi qendror i fshatit, kurse në lindje rreth 2,7 km kalon ruga e Konispolit. Në jug vsxhdojnë shtëpi, rreth 6 km është liqeni i Butrintit, kurse në veri, rreth 100 m larg, është shkolla 9-vjeçare “Aliko”

B- PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

a) Pershkrimi i jashtëm :

Prona, objekt i këtij vlerësimi, janë ambientet e zyrave të Postës, Aliko, te cilat ndodhen në një ndërtesë 1-katëshe. Posta ka në pronësi 98 m² ndërtesë dhe një sipërfaqe trualli prej 138 m². Aksesit në pronë realizohet direkt nga sheshi kryesor i fshatit, me lidhje me verandën dhe derën dy kanatëshe me zgara metalike, në anën veriperëndimore të godinës. Godina është e ndertuar me themele guri e butobeton, mure tulle, me solete beton arme monolite. Fasada është e pa suvatuar, e lyer dhe e veshur me gur nga ana perëndimore. Dyert dhe dritaret janë duralumini me xham dhe të mbrojtura me kangjella metalike por tejet të amortizuara. Prona ka edhe një derë me kangjella nga ana lindore e saj. Ambienti është i përshtatur në një ambient pritës dhe shërbimi me një sportel të ndarë.

b) Pershkrimi i brendshëm :

Prona përbëhet nga salla e klientëve me sportelin, tre ambiente zyrash, një magazinë, koridor dhe tualeti. Ajo paraqitet në përgjithësi në gjendje dhe kushte jo të mira mirëmbajtjeje. Ambientet e brendshme të pronës nuk janë rikonstruktuar për një kohë të gjatë, me dysheme të shtruara me pllaka gresi dhe të pajisur me plintuesa anësor përgjatë mureve por të ciflosura dhe dala boje. Banaku i sportelit është me melamine dhe me xham. Muret dhe tavanet janë të suvatuar dhe të lyer por ka prezence myku dhe lagështie. Vetratat e brendshme dhe dyert janë me profile duralumini. Tualeti është me paisje të thjeshta porcelani të amortizuara. Instalimet elektrike janë të vjetra por funksionojnë ndërsa lidhjet hidraulike janë pothuaj jashtë funksioni. Furnizimi me energji elektrike dhe ujë realizohet nga rjetet kryesore të zonës.



KËRKESAT E RIKONSTRUKSIONIT :

- **PRISHJET:** Të parashikohet mundësia e prishjes së të gjitha suvave ekzistuese për të dal në tullë si në ambientet e brendshme ashtu edhe te jashtme.
- **MURET:** Të parashikohet suvatimi në ambientet ndihmëse dhe patinim në sallën e shërbimit. Në muret që ka lagështirë të theksuar duhet parë mundësia dhe e veshjes së murit me veshje gipsi ose te shikohet mundesia e hiroizolimit dhe eliminimit te lageshtise. Për ndërtimin e dhomave të sigurisë të vlerave monetare parashikohet ndërtimi i tyre me murr dopjo tulle dhe dy breza betoni dhe dhomat e postës sekrete të parashikohet ndërtimi tyre me tulle të plotë dhe brez betoni , këto dhoma do të pozicionohen brenda zyrës postare.

- **LYERJE:** Të parashikohet lyerja me bojë të cilësisë së I-rë e të gjithë ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Zyrës Postare.
- **HIDROIZOLIMI:** Të parashikohet hidroizolimi i tarracave të objekteve me dy shtresa katrama dhe me ulluqe vertikale dhe horizontale(atu ku ka nevojë) si edhe hidroizolimi i mureve kur shihet e nevojshme
- **RIORGANIZIM I HAPESIRAVE:** Të parashikohet mundësia e prishjeve të mureve ekzistuese pa prekur kolonat e objektit/muret mbajtëse, për të krijuar një organizim më të mirë të sallës dhe të ambienteve ndihmëse duke u nisur nga organigramat e zyrave përkatëse dhe konsultimet me punjonjësit e zyrave përkatëse.
- **SHTRIMI ME PLLAKA:** Të parashikohet shtrimi me pllaka për të gjithë hapësirën e Zyrës Postare. *(Ngjyrat e pllakave vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)*
- **AKSESI PER PERSONAT ME AFTESI TË KUFIZUAR:** Te parashikohet ndertimi i rampave per aksesimin e personave me aftesi te kufizuar gjithashtu te parashikohet vendosja e udhëzuesve për personat me aftësi të kufizuar në shikim ne keto ambjente.
- **MOBILIMI:** Të parashikohet banak druri me ndarje xhami rezistent ndaj thyerjeve mbi sportel. Banaku duhet të jetë i paisur me komodina ndihmëse për secilin punonjës. Xhami mbi sportel duhet të jetë 50 cm i lartë dhe me 10 cm hapësirë boshe për të shkëmbyer materialet punonjësit me klientët.
- **TUALETET:** Të parashikohet tualete me të gjitha pajisjet e reja dhe aty ku nuk ka të parashikohet tualet i ri me të gjitha pajisjet. Të shikohet problematika e lagësirës në qoftëse ka dhe të bëhet hidroizolimi. Dyshemeja e tualetit të shtrohet me pllaka gres/porcelanat dhe veshja e mureve të tualetit të jetë me pllaka majolike. Tualeti duhet të pajiset me hidrosanitare të reja.
- **DYERT:** Të parashikohet që dyert të ndërrohen. Dyert e brendshme të Zyrës Postare duhet të jenë të gjitha prej druri ndërsa dera e tualetit të jetë material alumini. Dera e jashtme e Zyrës Postare, pra fasada duhet të jetë xham triplex me korniz alumini rezistente kundër thyerjeve. Fasada e xhamit duhet të jetë e veshur me adeziv ngjyrë akulli në lartësinë 110cm dhe në mes të saj të jetë e vendosur logo zyrtare e Postës Shqiptare.

(Ngjyrat e dyerve vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)

- **DRITARET:** Të parashikohet që dritaret të ndërrohen dhe të vendosen të reja. Dritaret ekzistuese duhet të zëvendesohen me dritare alumini dopjo xham ose me vetrata xhami triplex me korniz alumini rezistente kundër thyerjeve për zyrat qendër filiale. *(Ngjyrat e dritareve vendosen nga autoriteti kontraktor gjatë zbatim të punimeve)*
- **NDRICIMI:** Të parashikohet që ndriçimi të jetë LED me spote per sallat e shërbimit dhe ne ambjentet e tjera ku është parashikuar tavan gipsi me fibra 60X60 duhet të përdoret ndricues LED 60x60 tavanor.
- **TAVANI:** Në sallën e shërbimit të parashikohet tavan me kornizim anësor gipsi dhe pllaka gipsi me fibra 60x60
- **RRJETI ELEKTRIK:** Të parashikohet të bëhen të gjitha instalimet elektrike të reja, nga kuadri elektrik deri tek prizat. Për çdo post pune duhet të ketë 4 priza shuko të vendosura poshtë banakut. Në sallë dhe në ambientet ndihmëse duhen vendosur priza të reja.
- **RRJETI I INTERNETIT:** Të parashikohet që të vendosen 2 priza rrjeti interneti për secilin post pune, si dhe në ambjentet ndihmëse.
- **KONDITIONIMI:** Impiantet mekanike në godinë duhet të përzgjidhen në bazë të kërkesave më të larta të kursimit të energjisë, duke përdorur tipologji të përshtatshme për ambientet dhe destinacionin e tyre për realizimin e ngrohje ftohjes kondicionimin dhe furnizimin me ajër të freskët..
- **FASADA:** Të parashikohet pastrimi i të gjithë fasadave së jashtme të objektit, suvatim dhe grafiato, rehabilitimin e trotuareve dhe ambienteve te jashtme , ndricimimi i tyre. *(Ngjyrat e fasadës vendosen nga autoriteti kontraktor në zbatim të punimeve)*

- **TABELA:** Të parashikohet vendosja e një tablele treguese të re të Zyrës Postare në hyrjen kryesore me material etalbond me çarje me ndriçim dhe me sensor të erësirës ku të jetë e shënuar “Posta Shqiptare” dhe kodi postar.
- **TABELA EMERGJENCE DHE SINJALISTIKA E MZSH-së:** Të parashikohet projekti dhe planimetria e MZSH-së, vendosja e tabelave sinjalizuese në rast emergjence dhe sinjalistika e MZSH-së.

DORËZIMET E PROJEKTIT

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

-Projekti për rikonstruksionin e Zyrove Postare do të hartohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe kushteve teknike të projektit të zbatimit.

-Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin teknik përshkruar të punës për secilin prej punimeve, preventivin e punimeve të parashikuara dhe grafikun e punimeve për secilin Filial më vete.

-Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe preventivin përfundimtar përkatës.

-Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi.

-Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar) ose analiza të reja teknike.

Çmimet për projektim do të jetë sipas standarteve të shtetit Shqiptar.

Projekti Arkitektonik

| | |
|------------------------------------|--------------------------|
| Planvendosja e objektit | Shk. 1:500 |
| Planimetritë e gjendjes ekzistuese | |
| Planimetritë e ndërhyrjeve | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e propozuara teknike | Shk. 1:100 |
| Prerje gjatësore dhe tërthore | Shk. 1:100 |
| Detaje të ndryshme arkitektonike | Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10 |

Projekti Hidraulik

| | |
|----------------------------------|-------------------|
| Planimetritë e furnizimit me ujë | Shk. 1:100 / 1:50 |
|----------------------------------|-------------------|

Planimetritë e shkarkimit të ujrave të zeza Shk. 1:100 / 1:50

Detaje të ndryshme hidraulike Shk. 1:25/ 1:20/
1:10

Projekti Mekanik (Ngrohje Ftohje)

Planimetritë e vendosjes së pajisjeve ng-ft Shk. 1:100

Planimetritë e shtrirjes së instalimeve të kondicionimit Shk. 1:100

Detaje të ndryshme Shk. 1:25/ 1:20/
1:10

Projekti Elektrik dhe Internetit

Planimetritë e ndriçimit Shk. 1:100

Planimetritë e prizave Shk. 1:100

Planimetritë e rrjetit LAN, telefoni Shk. 1:100

Planimetritë e prizave te inernetit Shk. 1:100

Planimetritë e ndriçimit të emergjencës

Detaje të ndryshme Shk. 1:25/ 1:20/
1:10

Skema të kuadrove elektrike

Projekti i MNZ

Planimetritë e kateve ,Impianti i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi, Pozicionimin i Pajisjeve te MZSH.

Planet e evakuimit per secilin kat Shk. 1:100

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit te respektoje te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi

- Jo të gjitha objektet i kërkojnë të gjitha pikat e mësipërme të Vizatimeve të projektit përfundimtar të zbatimit.
Projekti përfundimtar i zbatimit do të dorëzohet si material i printuar dhe elektronik. Projekti i zbatimit do të dorëzohet në 3 kopje të printuara dhe një kopje një CD në PDF e firmosur elektronikisht nga Operatori ekonomik gjithashtu elektronikisht të dërgohet i gjithë projekti i punuar në DWG. Vizatimet e projektit të zbatimit duhet të dorëzohen në format A3 sipas

sipërfaqes së objektit. Relacionet, specifikimet teknike, preventivi dhe grafiku i punimeve do të dorëzohen në format A4.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të konsultohet gjatë gjithë kohës me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e hapësirave të brendshme aty ku është e nevojshme, përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave, dizajni i rifiniturave, ambjenteve, banakëve dhe për mënyrat e preferencat e zgjidhjes arkitektonike.

Vlera e hartimit të projekteve të llogaritet në bazë të vendimit Nr. 354, datë 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” duke u nisur nga vlera e investimit. Kreu III PLANIFIKIMI I OBJEKTEVE, SEKSIONI I NDERTESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE Grupi tarifor Nr3.

Vlera Totale e investimit për 18 zyrat postare do të jetë 161,000,000 lekë pa Tvsh.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Kërkohet hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të mësipërm të Postës Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambienteve përreth dhe infrastrukturës.

Afatet e ekzekutimit:

Afati kohor për hartimin e projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a do të jetë **2 muaj kalendarik nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Dorëzimi i hartimit të projektit do të bëhet në dy faza :

- Faza e parë objektet nga 1 deri në 8 me afat 1 muaj kalendarik nga nënshkrimi i kontratës.
- Faza e dytë objektet nga 9 deri në 18 me afat nga 1 deri në 2 muaj kalendarik nga nënshkrimi i kontratës.

| Shërbimet | Përshkrimi | Shuma | Vendi i ekzekutimit | Afati i ekzekutimit |
|-----------|------------|-------|---------------------|---------------------|
| 1 | | | | |
| | | | | |

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

- Është hartimi i projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, që synon të krijojë ambiente bashkëkohore pune, rritjen e cilësisë së shërbimeve, përmirësimin e imazhit të saj, ambjenteteve përreth dhe infrastrukturës.
- Projektet e rikonstruksioneve të këtyre Objekteve, duhet të realizojnë dhe mundësojnë studimin dhe analizimin e problemeve ekzistuese si dhe dhënien e zgjidhjeve më optimale për realizimin e qëllimit përfundimtar.

Detyrat:

Projekti për rikonstruksionin e Zyrave Postare do të hartohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe kushteve teknike të projektit të zbatimit.

Projekti përfundimtar do të përfshijë vizatimet për të gjitha punimet që do kryhen, specifikimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara, relacionin teknik përshkrues të punës për secilin prej punimeve, preventivin e punimeve të parashikuara dhe grafikun e punimeve për secilin Filial më vete.

Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe preventivin përfundimtar përkatës.

Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi.

Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar) ose analiza të reja teknike.

Çmimet për projektim do të jetë sipas standarteve të shtetit Shqiptar.

Projekti Arkitektonik

| | |
|------------------------------------|--------------------------|
| Planvendosja e objektit | Shk. 1:500 |
| Planimetritë e gjendjes ekzistuese | |
| Planimetritë e ndërhyrjeve | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e propozuara teknike | Shk. 1:100 |
| Prerje gjatësore dhe tërthore | Shk. 1:100 |
| Detaje të ndryshme arkitektonike | Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10 |

Projekti Hidraulik

| | |
|---|--------------------------|
| Planimetritë e furnizimit me ujë | Shk. 1:100 / 1:50 |
| Planimetritë e shkarkimit të ujrave të zeza | Shk. 1:100 / 1:50 |
| Detaje të ndryshme hidraulike | Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10 |

Projekti Mekanik (Ngrohje Ftohje)

| | |
|---|------------|
| Planimetritë e vendosjes së pajisjeve ng-ft | Shk. 1:100 |
|---|------------|

| | |
|--|--------------------------|
| Planimetritë e shtrirjes së instalimeve të kondicionimit | Shk. 1:100 |
| Detaje të ndryshme | Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10 |

Projekti Elektrik dhe Internetit

| | |
|---|--------------------------|
| Planimetritë e ndriçimit | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e prizave | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e rrjetit LAN, telefoni | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e prizave të internetit | Shk. 1:100 |
| Planimetritë e ndriçimit të emergjencës | |
| Detaje të ndryshme | Shk. 1:25/ 1:20/ 1:10 |

Skema të kuadrove elektrike

Projekti i MNZ

| | |
|---|--------------------------|
| Planimetritë e kateve ,Impianti i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi, Pozicionimin i Pajisjeve të MZSH. Planet e evakuimit për secilin kat | Shk. 1:100 Shk. 1:100 |
|---|--------------------------|

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit të respektojë të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standartet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri

- Jo të gjitha objektet i kërkojnë të gjitha pikat e mësipërme të Vizatimeve të projektit përfundimtar të zbatimit.

Projekti përfundimtar i zbatimit do të dorëzohet si material i printuar dhe elektronik. Projekti i zbatimit do të dorëzohet në 3 kopje të printuara dhe një kopje në CD në PDF e firmosur elektronikisht nga Operatori ekonomik gjithashtu elektronikisht të dërgohet i gjithë projekti i punuar në DWG.

Vizatimet e projektit të zbatimit duhet të dorëzohen në format A3 sipas sipërfaqes së objektit. Relacionet, specifikimet teknike, preventivi dhe grafiku i punimeve do të dorëzohen në format A4.

Shënim:Operatori ekonomik duhet të konsultohet gjatë gjithë kohës me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e hapësirave të brendshme aty ku është e nevojshme, përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave, dizajni i rifiniturave, ambjenteve, banakëve dhe për mënyrat e preferencat e zgjidhjes arkitektonike.

Shpërndarja:

- Shërbimi për hartimin e projekt - preventivave për punimet e rikonstruksioneve të Objekteve të Postës Shqiptare sh.a, të jetë sipas filialeve të Posta Shqiptare sh.a:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

- Në Ambjentet e Filialeve të Postës Shqiptare sh.a.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të konsultohet gjatë gjithë kohës me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e hapësirave të brendshme aty ku është e nevojshme, përzgjedhjen e materialeve, ngjyrave, dizajni i rifiniturave, ambjenteve, banakëve dhe për mënyrat e preferencat e zgjidhjes arkitektonike. Autoriteti Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a , në përcaktimin e fondit limit për këtë procedurë është bazuar në vendimin Nr 354 , datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori , projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” , Grupi tarifor III.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmartjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e sigurimit të ofertës është **73,476.9** (shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) Lekë.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre vitet e fundit 2020,2021,2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 19% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për studim/projektim (leshuar nga MZHUT/MEI) lidhur me ekzekutimin e kontratës ku të përfshihen kategoritë për projektim në kategoritë si më poshtë (sipas modelit të miratuar me Vendim Të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016):

1. PROJEKTUES ARKITEKT

2 a- Projektim arkitekturor për objekte banimi–objekte industriale–objekte turistike.

2 c- Projektim interiere.

2 d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

3a- Objekte civile-industriale–turistike prej murature e skelet betonarme deri në 5 kate.

3. PROJEKTUES INSTALATOR

4a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

4b- Projektim të instalimeve termo teknike–kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

4f- Projektim i sistemeve kundra zjarrit.

4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

5b- Projektim furnizim me ujë–kolektorë shkarkimi.

5. PROJEKTUES ELEKTRIK

4c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4j-Projektim i rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit etj (për objektet civile dhe industriale)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencat e drejtuesve teknike (inxhinierë) që do të përfshijnë për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë shënuar :

1 (një) inxhinier infrastrukture/ndërtimi/rruga ura

1 (një) arkitekt/urbanist

1 (një) inxhinier mekanik

1 (një) Inxhinier hidroteknik

